

# Mbledhja e kryesisë së shoqatës 17shkurti.ch

PROTOKOLL

DATA: 14.01.2018

KOHA: 11:00

VENDI: GLATTBRUGG

<b>THIRRUR NGA:</b>	Kryetari Muhamet Guda
<b>NUMRI I MBLEDHJËS</b>	11
<b>UDHËHEQËS I MBLEDHJËS</b>	Muhamet Guda
<b>PROTOKOLLIN E SHKRUAN</b>	Visar Kryeziu
<b>PJESËMARRËS</b>	Faik Mahmuti, Avni Kastrati, Muhamet Guda, Agron Zahiri, Visar Kryeziu
<b>MUNGOJNË</b>	Askush

## TEMAT E DITËS

1. Parapregaditja per Kuvend
2. Te ndryshme

DISKUTIMI	Tema Nr. 1 Parapregaditja per Kuvend	
<p>U diskutua qe kryesia te vij nje ore me heret pra ne ora 10:45; zerimin dhe llogo e shoqates ne carade te siguroj Avnia. Gjithashtu u diskutua qe ne kuvend te dilet me propozime per udheheqes te dites per Enver Foniqin si dhe pocesmbajtes te propozohet Visar Kryeziu.</p> <p>Shtypi i ftesave dhe raporti financiar rreth 450 flete i ka shtyp falas Ilaz Ilazi ndersa fletepagesat prej total 225 cope i ka shtyp gjithashtu falas vet arkatari Agron Zahiri, per kete kryesine e njoftoi Agroni. Kryesia per kete i falenderon Ilazin dhe Agronin.</p> <p>Per te ardhmen edhe Muhamet Guda tregoi se mundet per shtyp te fleteve ti kryej falas djali i tij, ne menyre qe mos te kete shpenzime nga shoqata.</p> <p>Arkatari Agron Zahiri njoftoi se sa i perket raportit financiar, ai ka pregaditur nje raport te detajizuar dhe i ka derguar te gjithe anetareve ne email te cilet kane pasur E-mail adresat e tyre te regjistruara tek shoqata.</p> <p>Tek raporti financiar, Faik Mahmuti ka nje verejtje se pse nuk eshte lene si projekte vecmas per projektin e blerjes se shtepise si dhe makines se pastrimit te rrugeve, por keto dy projekte jane futur te te ndryshmet.</p> <p>Revizoret Burhan Hajdari dhe Enver Tahiri se bashku ishin takur ne fund te vitit me arkatarin e shoqates per te kontrolluar hyrje daljet nga konto e shoqates dhe sipas Agronit ata kishin bere nje kontroll te detajizuar.</p> <p>Diskutohet per kryetar, sekretar dhe arkatar te ardhshem te shoqates per propozimet e mundshme mirepo nga kryesia nuk u kerkua qe te votohet per kete.</p>		
VENDIMI		
Kryesia te takohet nje ore para se te filloj kuvendi, ne menyre qe te pregaditet me mire.		
DETYRAT	PERSONI PËRGJEGJËS	TERMINI
Kryesia te takohet ne ora 10:45	kryesia	21.01.2018

DISKUTIMI	Tema Nr. 2 Te ndryshme	
<p>Kryetari Muhamet Guda njoftoi kryesine per propozimin e marr nga Agron Murseli qe per nder te 10 vjetorit te shtetesise se Kosoves, te behet nje projekt tek shkronjat "Urime Pavaresia" Fjala eshte qe te ndriqohet, mirepo ende nuk ka ndonje plan konkret si dhe kosto e saj.</p> <p>Visari tha qe kjo ide eshte e mire mirepo ky projekt duhet ti takoj kryesise se re sepse ne si kryesi nuk duhet te marrim me ndonje projekt per ta realizuar shkaku qe na ka mbetur vetem edhe nje jave kohe deri ne kuvend, dhe me mire eshte qe te shfrytezohet kjo energji per nje Kuvend me te mire.</p> <p>Agroni thote qe te bisedohet me Agron Murselin me konkret se per cfar projekti behet fjala me ne detale.</p> <p>Ne si kryesi na pelqen kjo ide, mirepo kerkojme nga Agroni qe ta detalizoj planin si me kosto ashtu edhe se se si do te duket, kurse Agron Murseli kete projekt te ia paraqesin kryesise re. Per kete tem do te kontaktoj Avni Kastrati me Agron Murselin.</p> <p>U diskutua gjithashtu se Falenderimet qe i jane shperndare sponzoreve te shoqates, me te vertet ka qene nje gje i mire sepse sponzoreve u ka ardhur shume mire per kete.</p>		
VENDIMI	/	
DETYRAT	PERSONI PËRGJEGJËS	TERMINI
/	/	/